



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA KRUIJË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 33 date 30 /04 /2018

Per

“Miratimin e kërkesës së Bashkisë Krujë, sëbashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Zj.Rolanda Dejeli, Z. Lulzim Vathi dhe Z. Petrit Sana , banesa të cilat janë dëmtuar nga djegia, nga buxheti i bashkisë dhe buxheti i Ministrisë e Mbrojtjes, programi”Emergenca Civile”

Baza Ligjore

Keshilli i Bashkise, ne mbledhjen e tij te dates 30.04.2018, pas shqyrtimit te relacionit te paraqitur nga Bashkia Kruje ,ne mbeshtetje te, ligjit nr. 8756 date 26.3.2001 “Per Emergjerncat Civile”, i ndryshuar, VKM nr 329 date 16.05.2012 “ Per krieteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shtetore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera”, i ndryshuar, Udhezimit te perbashket te Ministrise se Mbrojtjes dhe Ministrise se Financave nr.263 date 25.04.2013 “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shtetore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore”, process-verbalit te konstatimeve te demeve te shkaktuara, mbi vleresimet e grupit të punës per demet ne orendi, paisje dhe mobilje,

VENDOSI

- 1- Të miratojë kërkesën e bashkisë krujë për mbështetjen financiare të shtetases Zj.Rolanda Dejeli, Z.Lulzim Vathi, Z.Petrit Sana, për dëmtimin e banesës së tyre nga djegia.
- 2- Të miratoi dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Krujë.

- 3- Ti akordoi familjeve të shtetasve, përkatësisht, Zj.Rolanda Dejeli, Z.Lulzim Vathi, Z.Petrit Sana, ndihmën emergjente në vlerën nga 100000(njëqind mijë) lekë, nga buxheti i bashkisë Krujë , fondi i emergjencave civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i bashkisë Kruje për vitin 2018.
- 4- Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithëshme të Emergjencave Civile, në Ministrinë e Mbrojtjes për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për shkak të pamundësisë për të mbuluar të gjithë vlerën.
- 5- Ndhima financiare për familjen e shtetasve, Zj.Rolanda Dejeli, Z.Lulzim Vathi, Z.Petrit Sana, përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.39, datë 16.05.2012.
- 6- Ndhima financiare që do të akordohet, do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjeve të shtetasve Zj.Rolanda Dejeli, Z.Lulzim Vathi, Z.Petrit Sana, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga djegiet.

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Durrës.

KRYETARI

Hysni CACA

